



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1792/ 9 prot.,

Datë 25.06.2026

V E N D I M

Nr. 868 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25 .06.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Skyline SC” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, *Mallra* , "Blerje pjesë këmbimi, vaj dhe goma", e ndarë në lote, **Loti 3** me Nr. REF-85626-05-14-2026, me objekt “Blerje vaj, filtra dhe materiale të tjera” me fond limit: 1,768,657 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.05.2026 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Pogradec.

Ankimues: Operatori ekonomik “Skyline SC” ShPK, me Nipt M51624039U, *Adresa:Rr. Tulla 3, Z. Kadastrale 8320, Nr.pasurie 3/1431/ND, Nj. Bashkiake nr.1, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike Pogradec.
Adresa: Lagjja nr.2, Bulevardi "Reshit Çollaku", Pogradec.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit

të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.05.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, *Mallra*, "Blerje pjesë këmbimi, vaj dhe goma", e ndarë në lote, **Loti 3**, me Nr. REF-85626-05-14-2026, me objekt “Blerje vaj, filtra dhe materiale të tjera” me fond limit: 1,768,657 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.05.2026 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Pogradec.

II.2. Në datën 26.05.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), Autoriteti kontraktor ka vlerësuar ofertat sipas renditjes:

1. Skyline SC ShPK	me vlerë	1,333,600 L.pa Tvsh	Skualifikuar
2. ELBA-OIL 2015 ShA	“	1,471,950 “	Kualifikuar

3. KEJ ShPK	“	1,502,310	“	Kualifikuar
4. ADA-CO ShPK	“	1,573,380	“	Kualifikuar

II.4. Në datën **04.06.2026** është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numra ankimimi elektronik:

A/2026/6766, date 08.06.2026 dhe me Nr. 1792/2026 Prot., date 08.06.2026,
A/2026/6767 date 08.06.2026 dhe me Nr. 1792/1/2026 Prot., date 08.06.2026,
A/2026/6768 date 08.06.2026 dhe me Nr. 1792/2/2026 Prot., date 08.06.2026,
A/2026/6769 date 08.06.2026 dhe me Nr. 1792/3/2026 Prot., date 08.06.2026,
A/2026/6774 date 08.06.2026 dhe me Nr. 1792/4/2026 Prot., date 09.06.2026,

nga operatori ekonomik “Skyline SC” ShPK, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, Mallra, "Blerje pjesë këmbimi, vaj dhe goma", e ndarë në lote, **Loti 3**, me Nr. REF-85626-05-14-2026, me objekt “Blerje vaj, filtra dhe materiale të tjera” me fond limit: 1,768,657 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.05.2026 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Pogradec.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Skyline SC” ShPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formularin për publikim nr. 1792/5 prot., datë 09.06.2026 lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues në lidhje kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij.

II.7. Me shkresën protokolluar me tonën me Nr.1792/6 prot., datë 15.06.2026 ardhur në Sistem, autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij.

Referuar Vendimit të KSHA-së nuk ka pranuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues.

II.8 Në përputhje me **nenin 113** të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, referuar dosjes administrative, konstatohet se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuar në lidhje me ankesën.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Skyline SC” ShPK mbi kundërshtimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin nga procedura e prokurimit me arsytet:

Arsye e skualifikimit:

Komisioni i Vleresimit të Ofertave vendosi që të bëjë shqyrtimin e ofertës së “Skyline SC” shpk me oferte ekonomike 1,333,600 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

-I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.

- Nuk i plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.

- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

1.KVO vlerëson se nga verifikimi i dokumentacionit në përmbushjen e kriterëve të kapacitetit ekonomik dhe financiar, OE “Skyline SC” Shpk, nuk ka depozituar në sistem vërtetim xhiron për vitet 2023,2024 sikurse është kërkuar në përmbushje të kriterit në pikën 2.2.1 të shtojcës 8, të dokumentave standarte të tenderit, ku kërkohet:

“2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023-2024-2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% të vlerës së fondit të limit”.

Për sa më sipër operatori ekonomik “Skyline SC” Shpk nuk i përmbush kriteret e sipërcituar.

Nga sa më sipër, KVO vlerëson se në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

KVO gjykon se ky kriter do të konsiderohet i papërmbushur nga ofruesi “Skyline SC” shpk.

Bazuar dhe në vendimin e KPP-se nr.100/2026 prot date 19.01.2026, operatori ekonomik Skyline SC” shpk nuk i plotëson kriterin e DST.

Pretendimi argumentuar nga operatori ekonomik në ankesë:

Në lidhje me këtë sqarojmë se, në SPE kemi paraqitur dokument: Vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit me nr. Nr. T15457345 datë 06.04.2026 me vlerë 14,069,353 lekë. Sa i takon xhiros vjetore për vitet 2023-2024 nga shoqëria jonë nuk mund të paraqitet asnjë e dhënë për atë kohë sa shoqëria është themeluar në vitin 2025 siç vërtetohet nga ekstrakti i thjeshtë dhe historik në QKB. Për pasojë, nuk ekziston mundësia objektive dhe ligjore për të paraqitur deklaratatë të xhiros vjetore për vitet 2023 dhe 2024, pasi subjekti nuk ka ushtruar aktivitet gjatë këtyre viteve. Gjithashtu në kërkesën për plotësimin e këtij kriteri shprehet qartësisht se: ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së secilit prej loteve/shumatores se loteve për të cilat konkuron.

Sa më sipër, ky kriter plotësohet me xhiron vjetore të shoqërisë për vitin 2025.

III.1.1. Autoriteti Kontraktor ka trajtuar ankesën dhe me vendimin e KSHA-së ka Vendosur mospranim të pretendimeve në mënyrë të përmbledhur si vijon:

Referuar Ankesës së OE "Skyline SC" shpk, gjejmë pretendimet e tij si më poshtë:

1. Në lidhje me pretendimet për kriterin e xhiros vjetore. Për sa i përket pretendimit të OE "Skyline Sc" shpk në lidhje me xhiron vjetore sqarojmë se në Dokumentet e Tenderit, në kriteret e kualifikimit, është kërkuar paraqitja e dokumentacionit që provon xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për vitet financiare 2023 dhe 2024, por vetëm një vërtetim të xhiros për vitin 2025. Pretendimi i operatorit ekonomik se shoqëria është themeluar në vitin 2025 nuk ndryshon faktin se dokumentacioni i kërkuar në Dokumentet e Tenderit nuk është paraqitur i plotë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.2. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, Dokumentet e tenderit, shtojcën 8,

Loti 3 “Blerje vaj, filtra dhe materiale të tjera”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023-2024-2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së secilit prej loteve/shumatores se loteve për të cilat konkuron)

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) Komisioni konstatoi se në funksion të plotësimit të kriterit të mësipërm operatori ekonomik ka paraqitur dokumentin emertuar xhiro_06_04_2026 , në brendi të të cilit është

Vërtetimi nga Drejtoria Rejonale e Tatimeve Tiranë si vijon:

VËRTETIM
(Për Xhiron e Tre Viteve Të Fundit)

Vërtetohet se Personi Juridik / Fizik:

Z./Znj. Enid Dine

Tatimpaguesi: Skyline SC

NIPT-i: M51624039U

Aktiviteti: Aktivitete të këshillimit për biznes dhe këshilla të tjera për manaxhimin

Adresa: Tirane Tirane Rruga Tulla 3, Zona Kadastrale 8320, Nr.pasurie 3/1431/ND, Njesia Bashkiake nr.11

në bazë të të dhënave të situatës financiare të paraqitura për vitet e mëposhtme ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve si më poshtë:

Nr.	Periudha Tatimore	Shuma
1	25-A	14,069,353

III.1.4. Referuar ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 2, parashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar në shtojcën 8, **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023-2024-2025, **ku vlera e xhiros për të paktën**

një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e e vlerës së secilit prej loteve/shumatores se loteve per te cilat konkurron)

Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) Komisioni konstatoi se në funksion të plotësimit të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Skyline SC” ShPK ka paraqitur dokumentin emertuar

Xhiro_06_04_2026 , në brendi të të cilit ndodhet: Vërtetimi , nr .T15457345, datë. 06.04.2026, cituar më sipër në pikë III.1.3.

III.1.8. Komisioni thekson se Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat, kriteret dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me DST-në, për sa kohë i kanë pranuar dhe nuk i kanë kundërshtuar.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni mori në shqyrtim dokumentin e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, bazuar në kriterin kualifikues dhe kreu vlerësimin si vijon:

Përllogaritur vlerën 30% te fondit të Lotit 3 - rezulton: $1.768,657/30\% = 530,597.1$

përllogaritur vlerën 30% te fondit të procedures (3 Lote) rezulton: $4,514,124/30\% = 1,354,237,^{12}$

Dokumenti i operatorit ekonomik mban vlerën mbi xhirot vjetore **14,069,353** Vlera e së cilës tejkalon vlerën 30% të fondit limit sikurse është kërkuar në kriter.

Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë në lidhje me arsyet e skualifikimit për mospërbushje të kriterëve kualifikuesë 2.2.1. **ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e e vlerës së secilit prej loteve/shumatores se loteve per te cilat konkurron**, dhe se Dokumenti i paraqitur nga ankimuesi plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Skyline SC” ShPK qëndron.

III.2. Në lidhje pretendimet e operatorit ekonomik mbi kundërshtimin e vendimit të KVO-së, mbi arsyen e skualifikimi për mospërbushje të kriterit **2.3.1**

2. KVO gjithashtu vlerëson se OE për të përmbushur kriterin 2.3.1 në lidhje me furnizimet e ngjashme ka paraqitur faturën 19/2025 datë 18.08.2025, faturën 5/2025 datë 26.05.2025 dhe faturën 22/2025 datë 01.09.2025, fatura të cilat rezultojnë të kenë si objekt furnizimin me pjesë këmbimi, ndërkohë që objekti i procedurës së prokurimit lidhet me vajra/filtra, duke mos provuar që operatori ekonomik mundet realisht të furnizojë me mallrat objekt prokurimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e OE “Skyline SC” Shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

Argumentuar ankesa:

Nga ana jonë janë dorëzuar faturat me nr. **19/ 2025** me datë 18.08.2025, me vlerë **735 000,00** lekë **e cila ka shërbime të vajit dhe filterave për mjete të ndryshme.**

Gjithashtu faturat **5/2025 dhe 22/2025** të cilat janë ngushtësisht të lidhura me objektin e kontratës e cila përfshin shërbim riparim mjetesh, duke respektuar arsyetimin ligjor se këto janë punë të ngjashme dhe të së njëjtës natyrë. Megjithatë, vlera e faturës 19/2025, 735 000 (shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë është e mjaftueshme për të plotësuar vlerën 20 % të caktuar në DST. Referuar fondit limit të procedurës, vlera e punëve të ngjashme duhet të jetë jo më pak se 353,731.4 (treqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tridhjetë e një presje katër. Në këto kushte, kundërshtojmë vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i cili ka skualifikuar ofertën ekonomike të paraqitur nga ana jonë për arsye të mos përmbushjes së kritërit Teknik të kualifikimit, pika 2.3.1. Për përmbushjen e këtij kriteri nga ana jonë janë paraqitur fatura të puneve të ngjashme në vlerën e përcaktuar në DT.

Ky nuk mund të përbëjë shkak për skualifikim për aq kohë sa fatura tatimore vërteton përfundimin me sukses të kontratës.

III.2.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, Dokumentet e tenderit, shtojcën 8,

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT për Lotin 3

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së secilit prej loteve/shumatores se loteve për të cilat konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.**
- b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.**

“Loti 3 Blerje vaj, filtra dhe materiale te tjera” mallrat e kërkuara si vijon:

Mjeti 1	Nr	Lloji i materialit	Njësia	Sasia
J.S.B Tereks AFMT-07 COCCJS-880 Eliter Viti i Prodhimit 2012	1	Filter vaji motori	cope	3
	2	Filter nafte	cope	3
	3	Filter ajri	cope	2
	4	Vaj motori 15W40	Liter	30
	5	Vaj hidrauliku W 46	Liter	100
	6	Vaj kamio diferencial 80W90	Liter	10
	7	Graso jeshile cilesore	Kg	5
	8	Alkool frenash	Liter	5
	9	Vaj kamio automatike	Liter	40
Mjeti 2	Nr.	Lloji i materialit	Njësia	Sasia
MAN AA.517.PT shasi WMAH25ZZ24M378527	1	Filter vaj motori	cope	3
Modeli TGA 26480 Viti prodh. 2003	2	Filter nafte	cope	3
	3	Filter ajri	cope	3
	4	Vaj motori 15W40	Liter	100
	5	Vaj hidrauliku W 46	Liter	40
	6	Vaj kamio diferencial 80W90	Liter	40
	7	Vaj 10 W (I kuq)	Liter	5
	8	Graso jeshile cilesore	Kg	5
	9	Alkool frenash	Liter	5
Mjeti 3		Lloji i materialit	Njësia	Sasia
AA 258 UF me nr shasie WDB60231210792166	1	Filter vaj motori	cope	2
	2	Filter vaj kamio	cope	2
	3	Filter vaj hidrauliku	cope	2
	4	Filter nafte	cope	2
	5	Filter ajri	cope	2
	6	Parafilter	cope	2
	7	Vaj motori 10W40	Liter	20
	8	Vaj hidrauliku W 46	Liter	10
	9	Vaj kamio diferencial 80W90	Liter	10
	10	Graso jeshile cilesore	Kg	5
	11	Alkool Frenash	Liter	3
Mjeti 4		Lloji i materialit	Njësia	Sasia
Rrul Marka HAMM	1	Filter vaj motori	cope	2

	2	Filter vaj kamio	cope	2
	3	Filter vaj hidrauliku	cope	2
	4	Filter nafte	cope	2
	5	Filter ajri	cope	2
	6	Parafilter	cope	2
	7	Vaj motori 10W40	Liter	15
	8	Vaj hidrauliku W 46	Liter	10
	9	Vaj kamio diferencial 80W90	Liter	10
	10	Graso jeshile cilesore	Kg	5
	11	Vaj kamio automatike	Liter	20
Mjeti 5		Lloji i materialit	Njësia	Sasia
AA 189 YP me nr shasie VSKCVND40U0286509 NISSAN modeli NAVARA VITI PRODHIMIT 2008	1	Filter vaj motori	cope	2
	2	Filter vaj kamio	cope	2
	3	Filter vaj hidrauliku	cope	2
	4	Filter nafte	cope	2
	5	Filter ajri	cope	2
	6	Parafilter	cope	2
	7	Vaj motori 10W40	Liter	20
	8	Vaj hidrauliku W 46	Liter	20
	9	Vaj kamio diferencial 8W/90	Liter	20
	10	Graso jeshile cilesore	Kg	5
	11	Alkool frenash	Liter	3
	12	Vaj kamio automatike	Liter	20
Mjeti 6		Lloji i materialit	Njësia	Sasia
Traktor	1	Filter vaj motori	cope	2
	2	Filter vaj kamio	cope	2
	3	Filter vaj hidrauliku	cope	2
	4	Filter nafte	cope	2
	5	Filter ajri	cope	2
	6	Parafilter	cope	2
	7	Vaj motori 20W50	Liter	40
	8	Vaj hidrauliku W 46	Liter	40
	9	Vaj kamio diferencial 80W90	Liter	50
	10	Graso jeshile cilesore	Kg	50
Mjeti 7		Lloji i materialit	Njësia	Sasia
AA 217 GR me nr shasie WF0FXXTTFFDB48094	1	Filter vaj motori	cope	2

FORD TRANSIT Viti Prodhimit 2013				
	2	Filter vaj kamio	cope	2
	3	Filter vaj hidrauliku	cope	2
	4	Filter nafte	cope	2
	5	Filter ajri	cope	2
	6	Parafilter	cope	2
	7	Vaj motori 10W40	Liter	20
	8	Vaj hidrauliku W 46	Liter	20
	9	Vaj kamio diferencial 80W90	Liter	10
	10	Graso jeshile cilesore	Kg	5
	11	Alkool frenash	Liter	3
Mjeti 8		LLoji i materialit	Njësia	Sasia
AA 223 GR me nr shasie WF0FXXTTFFDB48120 Ford Transit Me nr shasie WFOFXXTTFFDB48120	1	Filter vaj motori	cope	2
	2	Filter vaj kamio	cope	2
	3	Filter vaj hidrauliku	cope	2
	4	Filter nafte	cope	2
	5	Filter ajri	cope	2
	6	Parafilter	cope	2
	7	Vaj motori 10W40	Liter	20
	8	Vaj hidrauliku W 46	Liter	20
	9	Vaj kamio diferencial 80W90	Liter	10
	10	Graso jeshile cilesore	Kg	5
	11	Alkool frenash	Liter	3
Mjeti 9		LLoji i materialit	Njësia	Sasia
AA109TL NISSAN Modeli CABSTAR E110 Me nr shasie VWASBFTL0Y1127463, VITI PRODHIMIT 2001	1	Filter vaj motori	cope	2
	2	Filter vaj kamio	cope	2
	3	Filter vaj hidrauliku	cope	2
	4	Filter nafte	cope	2
	5	Filter ajri	cope	2
	6	Parafilter	cope	2
	7	Vaj motori 10W40	Liter	20
	8	Vaj hidrauliku W 46	Liter	100

	9	Vaj kamio diferencial 80W90	Liter	10
	10	Graso jeshile cilesore	Kg	5
	11	Alkool frenash	Liter	5
	12	Vaj kamio automatike	Liter	20
Mjeti 10		LLoji i materialit	Njësia	Sasia
AA 478 PG Daimler Benz Modeli 814D Me nr shasie WDB6703321N094345	1	Filter vaj motori	cope	2
	2	Filter vaj kamio	cope	2
	3	Filter vaj hidrauliku	cope	2
	4	Filter nafte	cope	2
	5	Filter ajri	cope	2
	6	Parafilter	cope	2
	7	Vaj motori 10W40	Liter	20
	8	Vaj hidrauliku W 46	Liter	20
	9	Vaj kamio diferencial 80W90	Liter	10
	10	Graso jeshile cilesore	Kg	5
	11	Alkool frenash	Liter	3
Mjeti 11		LLoji i materialit	Njësia	Sasia
AA625ZO Marka Nissan Modeli Navara Viti prodhimit 2008 Nr shasie VSKCVND40U0268471 AA625ZO	1	Filter vaj motori	cope	2
	2	Filter vaj kamio	cope	2
	3	Filter vaj hidrauliku	cope	2
	4	Filter nafte	cope	2
	5	Filter ajri	cope	2
	6	Parafilter	cope	2
	7	Vaj motori 10W40	Liter	20
	8	Vaj hidrauliku W 46	Liter	20
	9	Vaj kamio diferencial 80W90	Liter	20
	10	Graso jeshile cilesore	Kg	5

	11	Alkool frenash	Liter	3
	12	Vaj kamio automatike	Liter	20
Mjeti 12		Lloji i materialit	Njësia	Sasia
BOB CATT	1	Filter vaj motori	cope	2
	2	Filter vaj kamio	cope	2
	3	Filter vaj hidrauliku	cope	2
	4	Filter nafte	cope	2
	5	Filter ajri	cope	2
	6	Parafilter	cope	2
	7	Vaj motori 10W40	Liter	15
	8	Vaj hidrauliku W 46	Liter	50
	9	Vaj kamio diferencial 80W90	Liter	10
	10	Graso	Kg	5
	11	Alkool frenash	Liter	3
Mjeti 13		Lloji i materialit	Njësia	Sasia
AA203ZB (kamion vinç BENZ) me nr shasie 38514714953625 Viti prodhimit 1982	1	Vaj hidrauliku W 46	Liter	50
	2	Vaj motorri	Liter	50
	3	Filter nafte	cope	2
	4	Filter ajri	cope	2
	5	Filter vaji	cope	2
		Lloji i materialit	Njësia	Sasia
Mjeti 14 VOLVO EC 220 DL	1	Vaj motorri 15 - 40	litra	100
	2	Vaj hidraulik 46	litra	200
	3	Vaj per reduktoret plus rrotulluesi 90	litra	50
	4	Graso jeshile	kg	80
	5	Filter nafte	cope	5
	6	Filter vaji	cope	5
	7	Filter ajri	cope	5
	8	Parafilter nafte	cope	5
	9	Filter hidraulik 16019	cope	3
	10	Filter hidraulik FSO 913 / 1H	cope	3
	11	Filter ajri kondicionuar	cope	1
		Lloji i materialit	Njësia	Sasia

Mjeti 15 CATEPILLAR BACKHOE LOADER CFG1 MODEL 428-07A				
	1	Filter nafte	cope	5
	2	Filter vaji	cope	5
	3	Filter ajri	cope	5
	4	Parafilter nafte	cope	5
	5	Filter hidraulik 1R 0749	cope	2
	6	Filter hidraulik 3I-7651	cope	2
	7	Vaj motorri 10w - 30	litra	40
	8	Vaj hidraulik 10w	litra	40
	9	Vaj kamio diferencial 80-90	litra	20
Mjeti 16 AAMT37 Komatsu Modeli WB97R-2 Viti prodhimit 2000 Mjeti 17 Iveco AB970OT Mjeti 18 Eskavator Lloji:LT1010 Nr. Shasisë: LT25011878, Viti i prodhimit : 2025		Lloji i materialit	Njësia	Sasia
	1	Filter nafte	cope	3
	2	Filter vaji	cope	3
	3	Filter ajri	cope	3
	4	Parafilter nafte	cope	3
	5	Vaj motorri 10-40	litra	30
	6	Vaj hidrauliku ATF	litra	80
	7	Vaj kamio diferenciali 46	litra	80
	9	Vaj reduktori 80w90	litra	30
		Lloji i materialit	Njësia	Sasia
	1	Filter nafte	cope	2
	2	Filter vaji	cope	2
	3	Filter ajri	cope	2
	4	Vaj motorri 10-40	litra	30
	5	Vaj hidrauliku 10	litra	5
	6	Vaj hidrauliku 46	litra	25
	7	Vaj kamio diferenciali 80w 90	litra	10
		Lloji i materialit	Njësia	Sasia
	1	Filter vaj motori	cope	2

	2	Filter vaj kamio	cope	2
	3	Filter vaj hidrauliku	cope	2
	4	Filter nafte	cope	2
	5	Filter ajri	cope	2
	6	Parafilter	cope	2
	7	Vaj motori 10W40	Liter	15
	8	Vaj hidrauliku W 46	Liter	50
	9	Vaj kamio diferencial 80W90	Liter	10
	10	Graso	Kg	5
	11	Alkool frenash	Liter	3
Per te gjitha mjetet		Lloji i materialit	Njësia	Sasia
	1	Antifrizë	litra	300

III.2.2. Nga verifikimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet, se operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK në përmbushje të **kriterit 2.3.1** Mbi furnizimet të mëparshme, si më sipër cituar, ka ngarkuar dokumentet si më poshtë:



Pjese_kembimi_automjjetesh (1).pdf

ne brendi te te cilit ka

Fatura Elektronike Nr.19/2025 date 18.08.2025, Shitës Skyline SC SHPK M51624039U,

Blerës DR. Rajonale Policia Kufi EMIGRA, Kukës për Artikujt:

1. F/V Ferrota te para e te pasme (kit) 4 tamburot
2. Sherbim nderrimi i vajtit te (MB703AA 3 here ne vit) dhe Motorit, Kamjos, diferencialeve, grupit te Timonit dhe alkoolit te frenave dhe nderrimi i ferrotave.
3. F/V Ferrota te para e te pasme (Kit 4 tamburot) 2 here ne vit.
4. Sherbim nderrimi I vajit Motorit,Kamjos,Diferencialit,Grupit timonit, Alkoolit te frenave
5. F/V Ferrota te para e te pasme +Ferrota e Tamburos se frenave te Dore
6. Ratifikim testate dhe zevendesim guarnicioni per mjetet me targe MB 129 AA dhe MB127 AA
7. Sherbime te nderrimit te vajit Motorit,kamjos Ridotios,Diferencialeve, Grupit te timonit Alkoolit te frenave.
8. F/V.Ferrota te para e te pasme.
9. Sherbime te nderrimit te vajit te Motorit,Kamjos,Diferencialeve,Grupit te Timonit,Alkoolit te frenave.
10. F/V Kushinete qendrore e Ridotios +Permistop Prapaolje.
11. F/V Kushinete qendrore e Ridotios +Permistop Prapaolje
12. F/V Amortizatore te pare dhe te pasem.
13. Riparim i impiantit elektrik per mjetet
14. F/V Pinjon motorine per mjetet
15. F/VNderrim Volanti,Disk,Spacidisk,Kushinete

16. Riparim Dinamoje
17. Vendosje Maskarine Plastike perpara
18. F/V Koke paraleli Majtas
19. F/V Koke paraleli Djathtas
20. F/V Koke zbare
21. F/V Krah paraleli Majtas+Djathtas
22. Gomine krahu i pare PCS Majtas e djathtas
23. F/V Fshirese xhami
24. F/V Fshirese xhami
25. F/V Fshirese xhami
26. F/V Fshirese xhami
27. /V Guanicion testate dhe ratifikim mjetit
28. F/V nderrim kit Rip Motori,
29. F/V Pompe uji Motorit

Shuma Total 735 000 Lek pa Tvsh



Pjese_kembimi_Goma (1).pdf

Fatura Elektronike Nr.5/2025 date 26.05.2025 Shitës: Skyline SC SHPK M51624039U,

Blerës: SPITALI "OMER NISHANI", Gjiokastër për Artikujt:

1. Goma 225*70*R15C
2. Goma 235*65*R16C
3. Goma 225*65*R16C
4. Goma 215*65*R15C

Shuma totale 169.000 Lek pa Tvsh



Pjese_kembimi_Reparti_Ushtarak_4030 (1).pdf

Fatura Elektronike Nr.22/2025 date 01.09.2025 Shitës: Skyline SC SHPK M51624039U,

Blerës: REPART USHTARAK NR.4030, Ferraj, Dajt Tiranë.

1. Këmisha motori Astra
2. Guarnicion testate BM 201
3. Pompë freksioni BM 201
4. Valvula ajri BM 201
5. Valvul Shkarko BM
6. Pompë freni BM 201
7. Guarnicion Diferenciali Atobot uji

8. Guzhineta diferenciali Atobot uji
9. Kompresor Atobot uji Benz
10. Dinamo
11. Buka e kuadrit ,(Çipi i kuadrit)
12. Guarnicion testate Kamion
13. Solucion ngjitës guarnicioni Kamion
14. Ferrota të para Autozjarrfikse Ben
15. Ferrota të pasme Autozjarrfikse
16. Paralel i gjatë Autozjarrfikse
17. Paralel i shkurtër Autozjarrfikse
18. Gomina e topit Autozjarrfiks
19. Valvul qëndrore ajri me filtër filtër, projeksioni 12 bar
20. Shtrengues ngarkesash me mekanizem, 10 m, 2-4 Ton

Shuma totale 438 999,17 Lek pa Tvsh

III.2.3. Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.2.4. Në nenin 40, pikat 3 dhe 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore³⁷, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave

të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit publik vëren, se Kriteret për Kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Nga ana tjetër operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt ankimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin **2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së secilit prej loteve/shumatores se loteve për të cilat konkuron.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Komisioni thekson se Operatori ekonomik ofertues në një procedurë prokurimi është subjekti i parë i interesuar në përmbushjen e të gjitha kriterëve për kualifikim, përsa kohë i ka pranuar ato dhe ka ofertuar në procedurën e prokurimit.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon mbi dokumentacionin e procedurës së prokurimit dhe dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si pjesë e ofertës së tij, nga ku rezulton, se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentet cituar e listuar në pikën III.2.2 të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i dokumenteve të ofertës, depozituar në SPE, Komisioni konstatoi referuar dokumenteve:

Fatura Elektronike Nr.5/2025 date 26.05.2025 Shitës: Skyline SC SHPK M51624039U dhe Fatura Elektronike Nr.22/2025 date 01.09.2025 Shitës: Skyline SC SHPK M51624039U

dhe në analizë të artikujve pjesë e faturave, konstatoi se nuk janë të ngjashëm me objektin e prokurimit Loti 3, Blerje vaj, filtra dhe materiale të tjera dhe Formularin e Specifikimeve Tenknike, sipas Listës së artikujve në tabelat përkatëse.

Në vijim të trajtimit të dokumenteve të ofertës së operatorit ekonomik ankimues, Komisioni mori në shqyrtim dokumentin **Fatura Elektronike Nr.19/2025 date 18.08.2025, me Shitës Skyline SC SHPK M51624039U, dhe Blerës DR. Rajonale Policia Kufi EMIGRA, Kukës, faturë e cila** rezulton e realizuar *brenda tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*, periudhë kohore e përcaktuar në kriter, duke rezultuar e rregullt nga ana formale, dhe pas verifikimeve të listës së artikujve/mallra, Komisioni konstatoi artikujt të ngjashëm dhe çmimet për secilin artikull si vijon:

Pershkrim i mallrave	Vlera pa tvsh
2. Sherbim nderrimi i vajtit te (MB703AA 3 here ne vit) dhe Motorit, Kamjos, diferencialeve, grupit te Timonit dhe alkoolit te frenave dhe nderrimi i ferrotave	36 000 L
4. Sherbim nderrimi I vajit Motorit,Kamjos,Diferencialit,Grupit timonit, Alkoolit te frenave	10 000 L
7.Sherbime te nderrimit te vajit Motorit, kamjos Ridotios, Diferencialeve, Grupit te timonit Alkoolit te frenave	37,500 L
9.Sherbime te nderrimit te vajit te Motorit,Kamjos,Diferencialeve,Grupit te Timonit,Alkoolit te frenave.	52 800 L
Total Vlera	136,300

Komisioni gjykon se zërat e renditura në tabelë do të konsiderohen mallra/artikuj/sherbime të ngjashme në përputhje me objektin e **Lotit 3**. “Blerje vaj, filtra dhe materiale të tjera” me fond limit: 1,768,657 Lekë pa TVSH.

Gjithashtu Referuar argumenteve të ankesës, edhe operatori ekonomik pohon faktin se:

“Nga ana jonë janë dorëzuar faturat me nr. 19/ 2025 me datë 18.08.2025, me vlerë 735 000,00 lekë e cila ka shërbime të vajit dhe filtrave për mjete të ndryshme .”

Komisioni, për një vlerësim të drejtë bazuar në fakte dhe prova, kreu përlllogaritjet e vlerës 20% e fondit limit të Lotit 3= 1,768,657x20% ku rezulton=**353,731⁴** Lek, dhe krahasuar me Vlerë totale të zerave të ngjashme (tabela sipër) rezultoi vlera total e tyre në **136,300 Lek**. e cila konsiderohet nën vlerën 20% të vlerës së fondit limit përcaktuar në kriter.

Komisioni nga analiza e fakteve sipërcituar gjykon se operatori ekonomik “Skyline SC” ShPK me dokumentacionin e paraqitur nuk përmbush kriterin kualifikues **2.3.1** në procedurën se prokurimit objekt shqyrtimi.

Pretendimet e operatorit ekonomik “Skyline SC” ShPK nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 24 e në vijim të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Ligjit Nr. 10279 datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për

Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Skyline SC” ShPK për procedurën e prokurimit **Loti 3** , me Nr. REF-85626-05-14-2026, me objekt “Blerje vaj, filtra dhe materiale të tjera” me fond limit: 1,768,657 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.05.2026 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Pogradec
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik në lidhje me Arsyet e Skualifikimit, sipas konstatimeve të këtij vendimi.
3. Autoriteti Kontraktor, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni, të njoftojë KPP-në mbi veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij Vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “**Skyline SC**” ShPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

